

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM-DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ, sipas gjyqtares Nazife Beqiri, me sekretaren juridike Fatmire Mani, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehures Mirlinda Bytyqi-Rexhepi nga Ferizaj, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5,6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin të Pasurisë së zyrtarëve të lartë public dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë (Ligji nr.04/L-050), e në bazë të nenit 73, 74, 195 dhe nenit 199 të Ligjit Mbi Kundërvajtjet (ligj I aplikueshëm), më datën 12.09.2013 solli:

A K T V E N D I M

E pandehura Mirlinda Shaban Bytyqi-Rexhepi, e lindur më 06.06.1981, me vendbanim ne Ferizaj RR. "Riza Matoshi" Nr 12, e martuar, nënë e 2 femijëve, ka te kryer fakultetin juridik, e gjendjes se mesme ekonomike, delegate e Asamblesë Komunale të Ferizajt, Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosoves

E s h t ë P ë r g j e g j ë s e

Sepse, si delegate e Asamblesë së Komunës së Ferizajt, nuk ka vepruar sipas kërkeses se Agjencionit Kosovar Kunder Korrupsionit te dt.01.03.2012, pasi sipas Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave per te gjithë personat Zyrtare (Ligji nr.04/L-050), nuk e ka plotesuar formularin e ketij Agjencioni dhe nuk e ka deklaruar pasurine,

-me qka ka kryer kundervajtjen nga neni 17 par.1.3 lidhur me nenin 5al.1 te Ligjit per Deklarimin mbi Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik,

Andaj, ne baze te nenit 17 par.1.3 lidhur me nenin 5 al.1 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise dhe Dhuratave te Zyrtareve te larte Publik (Ligji nr.04/L-050) e ne veshtrim te nenit 9 te LK

D E N O H E T

ME DENIM ME GJOBE ne shume prej 500.00 E (Pesqind Euro)



Denimin e shqiptuar ne te holla e pandehura obligohet ta paguajë ne afat prej 15 ditesh, nga dita e plotfuqishmerise se ketij aktvendimi, e nese nuk e paguan ne afatin e lejuar ligjor, e njejta do t'i shndërrohet ne denim me burg ne kohezgjatje prej tridhjetë (30) ditesh.

Ne emer te shpenzimeve te procedures kundervajtese e pandehura obligohet te paguaj Shumen paushall prej 5 E, ne te njejtin afat sikurse denimin, nen kercenim te permbarimit te detyrueshem.

A r s y e t i m

Agjencioni Kosovar Kunder Korrupsionit ne Prishtine, ka parashtruar kërkesen nr.01-2206/12 te dt.04.06.2012 per fillimin e procedures kundervajtese ndaj Mirlinda Bytyqi-Rexhepi nga Ferizaj, per shkak te kundervajtjes nga neni 5,6 par 1.3 te Ligjit mbi Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollin e Pasurise se zyrtareve te larte public dhe deklarimin mbi prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave per te gjithë personat Zyrtare dhe ka propozuar qe I njejtë te shpallet pergjegjes dhe te denohet sipas ligjit.

Gjyqtarja zhvilloi procedurën kundërvajtëse dhe e degjoi te pandehuren e cila ne mbrojtjen e

REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT / AGENCIA PERITIV KORRUPCIE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. 	
Dep. <u>DPK/DMP</u>	Nr. Prot. <u>03-2930/13</u>
Nr.faq.	Data
Broj stranica <u>02</u>	Data <u>23.09.2013</u>
Nr. pages	Data
PRINTING	

vet dhene para kesaj gjykate me dt.05.11.2012 ka mohuar kundervajtjen qe I vihete ne barre dhe ka theksuar se nuk e kam pranuar formularin per deklarimin e pasurise as nuk kam qene e njohtuar se duhet ta plotesoj te njejtin dhe se nuk kam qene e ftuar nga personi zyrtar I pikes kontaktuese Naser Musa.

Per vertetimin e gjendjes faktike gjyqtarja ftoi deshmitarin Naser Musa, zyrtar I pikes kontaktuese te Komunes se Ferizajt I cili ka theksuar se materialet bashk me formularet qe I ka pranuar nga AKK ju kanë shperndare bashk me Afrim Matoshin te gjithë keshilltareve dhe delegatëve te Komunes duke ua lene ne tavoline ne mbledhjen e dt.09.03.2012, e poashtu kanë qene te njoftuar edhe gojarishte (se duhet te plotesohen formularet) nga kryesuesi Agim Aliu(tash kryetar I Komunes se Ferizajt) dhe prezentoj ne Gjykate regjistrin e anëtarëve pjesmarres ne ate mbledhje

Nderkaq deshmitari tjetër Afrim Matoshi, zyrtar per mbarvajtje te KK Ferizaj theksoi se ju ka shpernda keshilltarve dhe deputetëve formularet per deklarimin e pasurise(pasi te njejtin I ka marre nga Naser Musa) duke ia lene secillit keshilltare ne ulese dhe perpos Makfire Sadikut te gjithë Deputetët kane qene prezent dhe kryesuesi I ka njohtuar se formulari duhet te dorzohet presonalisht ne AKK.

Ne cilesinë e deshmitarit u ftua edhe perfaqesuesi I AKK Agron Behrami, I cile ne deklaraten e tij nder tjera theksoi se me hyrjen e ligjit te ri ne fuqi per deklarimin, prejardhjen e pasurise 04/L-050 tuese kemi kerkuar nga Naser Musa te na dergoje listen e zyrtarve te larte qe kane per obligim deklarimin e pasurise nga K Ferizaj e ne pyetjen e gjyqtares theksoi sekane per obligim qe edhe keshilltaret komunal ta bejne deklarimin e pasurise, ne pastaj nga pika kontak kerkesa te veqanta per deklarim te pasurise nuk u kemi derguar nga se kete nuk e parasheh ligji.

Në baze te deklarates se te pandehures, deklaratave te deshmitarëve, shkresave te lendes dhe bindjes se lire, gjyqtarja konstatoi se e pandehura ka kryer kundervajtjen me te cilen ngarkohet, per qka u shpall pergjegjese dhe u denua me gjobë si ne dispozitiv te ketij aktvendimi

Gjate matjes se denimit eshte marre parasysh pasha e kundervajtjes dhe pasojat e saja, rrethanat nen te cilat eshte kryer kundervajtja (nga pakujdesia), se nuk jane shkaktuar pasoja te renda, se eshte hera e pare qe e pandehura ka kryer kundervajtje. Gjyqtarja vendosi ta beje zbutjen e denimit nen minimumin ligjor konform nenit 9 al1 pika 1 te LK, duke marre perbaze edhe dispozitat e nenit 7 te LK-së, duke llogaritur se edhe me kete gjobe do te arrihet qellimi I ndeshkimit, ashtu qe I pandehuri ne te ardhmen te mos kryejë vepra te tilla apo te ngjashme

GJYKATA THEMELORE, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHEM – DIVIZIONI PER KUNDERVAJTJE NE FERIZAJ
Sekretarja juridike
Fatmire Mani



KESHILLA JURIDIKE:

Kunder ketij aktvendimi te pandehurit dhe parashtruesit

Te kerkeses iu lejohet ankesa ne Gjykatën e Apelit – Divizioni per Kundervajtje ne Prishtine, ne afat prej 8 ditesh, pas marrjes se ketij aktvendimi, permes kesaj Gjykate